



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ___/___/ 2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “albdesign-ppsp”sh.p.k, me administrator Z.Kleant Lami, me numër NIPT-i L51819005Q, me adresë: Tirane Kashar KASHAR Lagjia Mezeze, Rruga "Çerçiz Topulli", Nr.17, Ndertese Private, Zone Kadastrale Nr.2679, Numer Pasurie 17/36.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”

Numri i referencës së procedurës: REF-80920-07-27-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje libreza dhe kontrata”.

Fondi Limit: 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë.

Afati për lëvrimin e mallrave: 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e zhvillimit të tenderit është: 09.08.2018 Ora: 08:30

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.31 të dates 06.08.2018

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|------------|
| 1. “Albdesign Psp” sh.p.k | L51819005Q |
| Vlera 390.000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh | |
| 2. “Adel & Co” sh.p.k | L22117021M |
| Vlera 725.000 (shtatëqind e njëzetë e pesë mijë) lekë pa tvsh. | |
| 3. “Rama-Graf” | K42701205E |
| Vlera 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh. | |

4. **“Flesh”** sh.p.k
J91801004M
Vlera **782.000** (shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh
5. **“Infosoft Office” sh.p.k** J62426002Q
Vlera **892.750** (tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.
6. **“Onufri”sh.p.k** J91801003E
Vlera **900.000** (nëntëqind mijë)lekë pa tvsh.
7. **“Kristalina kh”sh.p.k** K11501002D
Vlera **927.000** (nëntëqind e njëzetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh.
8. **“Shtepia Botuese shtypëshkronja morava”** J82019001J
Vlera **1.050.000** (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“Onufri”sh.p.k** J91801003E
Vlera **900.000** (nëntëqind mijë) lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari Autoriteti Kontraktor në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 3.2 ka kërkuar si më poshtë cituar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit,(nga data e zhvillimit të tenderit)me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 600.000(gjashtëqind mijë)lekë pa tvsh.

- Kur furnizimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur kontratë me objekt “Botim libra e revista për KLSH”,datë 08.05.2015 me AK KLSH, prot 134/15, me vlerë 2.025.000 (dy milion e njëzetë e pesë mijë)lekë me tvsh shoqëruar me vërtëtim realizimi si dhe faturat tatimore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur K.V.O konstaton se kontrata e paraqitur paraqitur nga operatori ekonomik është jashtë afatit të kërkuar në DST si dhe në kundërshtim me rekomandimin e APP datë 20.03.2018 prot 3341/1 .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Albdesign PSP**” **sh.p.k.**, me adresë: Tirane KASHAR KASHAR Lagjja Mezeze, Rruga "Çerçiz Topulli", Nr.17, Ndertese Private, Zone Kadastrale Nr.2679, Numer Pasurie 17/36, me numër NIPT-i L51819005Q, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **390.000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.08.2018**

Ankesa:**JO**

